



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Marisa" Sh.P.K. të datës 12.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "12 Ndërtimi i rrugëve në fshatin Marmor" me nr. të prokurimit 616-24-3056-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Marisa" Sh.P.K. e datës 12.06.2024 kundër kundër njoftimit mbi vendimin e datës 07.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "12 Ndërtimi i rrugëve në fshatin Marmor" me nr. të prokurimit 616-24-3056-5-2-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 07.06.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Marisa" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 12.06.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 07.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "12 Ndërtimi i rrugëve në fshatin Marmor" me nr. të prokurimit 616-24-3056-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

"Pretendimi 1: GOE-ja nuk e ka plotësuar Aneksin nr. 7 të listës së projekteve; pra, ai aneks mungon dhe duhet eliminuar pa kërkuar sqarime shtesë, pasi që është administrativisht i papërgjegjshëm.

Pretendimi 2: Mungon dozeri (buldozeri me peshë 18-20 ton). GOE-ja ka paraqitur disa buldozerë të cilët nuk e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit, pasi që ka paraqitur buldozer me peshë 25ton dhe një tjetër me 13 ton. Duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit dhe në dokumentet e paraqitura sipas LPP-së dhe RROUPP-së, ai GOE është i papërgjegjshëm.

Pretendimi 3: Mungon cilindri gonië-hekur me peshë 2-2.5 ton. GOE-ja nuk ka paraqitur listën e makinerisë së specifikuar për këtë projekt; gjithashtu mungon ai cilindër në dosjen e tenderit dhe në listën e makinerisë, dhe për këtë makineri nuk mund të kërkojen sqarime shtesë dhe është i papërgjegjshëm.

Pretendimi 4: Mungon udhëheqësi i punishtes. GOE-ja ka paraqitur disa inxhinierë të ndryshëm, por nuk e ka specifikuar me vendim udhëheqësin e punishtes dhe ky kriter është i paplotësuar nga ai GOE i rekomanduar, dhe kjo ofertë duhet refuzuar pa kërkuar sqarime shtesë.

Pretendimi 5: Mungon ripërri (grëmqi). GOE-ja nuk ka paraqitur këtë pjesë dhe nuk është i specifikuar në listën e mjeteve të asnjëri nga GOE-të. Ju, si AK, keni kërkuar sqarime shtesë për këtë makineri, gjë që është në kundërshtim me LPP-në dhe me RROUPP-në, pasi që nuk keni dëshmi për të kërkuar sqarime shtesë. Neni 72 thotë se mund të kërkojen sqarime shtesë për dokumentet që gjenden në dosjen e tenderit.

Pika 3 Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Ky GOE ka një faturë dhe në të shkruan lug (kovë), dhe dallimi mes tyre është i madh. Pra, nuk është mjete i njëjtë siç është kërkuar në dosjen e tenderit, gjithashtu nuk është as në listën e mjeteve, siç e kemi cekur edhe më lart. Në këtë pikë, ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm dhe duhet refuzuar kjo ofertë.

Ky GOE ka paraqitur shumë makineri të cilat janë pa dëshmi dhe nuk mund të dëshmohet pesha dhe specifikimet e makinerive, si dhe në dosjen e tenderit është kërkuar që makineria e cila është me faturë të paraqitet dhe duhen dokumentet doganore".

Pika e parë e pretendimit ankimor të parashtruesit ndërlihet me kërkesën e dosjes së tenderit të formuluar si vijon "7.Lista e pajisjeve profesional të OE. Aneksi (7) 8 i DT". Nga administrimi me ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se i njëjti ka dorëzuar një listë me disa pajisje mirëpo nuk është plotësuar aneksi përkatës i dosjes së tenderit lidhur me këtë kërkesë të kapacitetit teknik dhe profesional. Plotësimi i formularit të dosjes së tenderit është kusht administrativ prandaj pretendimi ankimor i parashtruesit në këtë pikë është gjetur si i bazuar.

Pika e katërt e pretendimit ankimor të parashtruesit ka të bëjë me udhëheqësin e punishtes. Në ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se nuk është bashkangjitur asnjë vendim për emërimin e udhëheqësit të punishtes. Në ofertë ekziston një vendim për emërimin e menaxherit të projektit mirëpo nuk ekziston ngjashëm edhe vendimi për emërimin e udhëheqësit të punishtes. Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Pika 2 dytë, e tretë dhe e pestë e pretendimit ankimor të parashtruesit ka të bëjë me pajisjet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Nga analizimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar është gjetur se nuk janë bashkangjitur dëshmitë dokumentare sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit për buldozerin (buldozeri me peshë 18-20 ton); cilindrin gomë-hekur me peshë 2-2.5 ton. Prandaj edhe këto pretendime janë gjetur si të bazuara.


Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.16.2024



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.